



PROJEKT PËR PËRMIRËSIMIN E SHËRBIMEVE SOACIALE

Njoftim për vazhdimin e afatit për thirrjen e tretë publike për komunat dhe komunat në qytetin e Shkupit dhe ofruesit e mundshëm të shërbimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut për të aplikuar për grant për zhvillimin e shërbimeve sociale

Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë e vazhdon afatin e aplikimit për Thirrjen e Tretë Publike për komunat dhe komunat në qytetin e Shkupit dhe ofruesit e mundshëm të shërbimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut për aplikime për grant për zhvillimin e shërbimeve sociale. Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve është **21.02.2025 (e premte) deri në ora 16:00**

Republika e Maqedonisë së Veriut Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë

Thirrja e tretë publike për komunat dhe komunat në qytetin e Shkupit dhe ofruesit e mundshëm të shërbimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut për aplikime për grant për zhvillimin e shërbimeve sociale

Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë po zbaton Projektin për Përmirësimin e Shërbimeve Sociale (SSIP) me mbështetje financiare nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Kredia Nr: 8902-MK).

Një nga qëllimet kryesore të projektit është zhvillimi dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve sociale në komunitetet lokale, në përpunje me nevojat e qytetarëve dhe rritja e aksesit në shërbimet sociale të destinuara për grupet e cënueshme të qytetarëve, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe personat e tjerë.

Komunat, së bashku me ofruesit e mundshëm të shërbimeve, do të mund të aplikojnë për grante të destinuara për projekte për zhvillimin e shërbimeve sociale të mëposhtme:

- shërbime në shtëpi (Ndihmë dhe kujdes në shtëpi)



PROJEKT PËR PËRMIRËSIMIN E SHËRBIMEVE SOACIALE

- shërbimet në komunitet (qendër ditore për personat me aftësi të kufizuara, qendër ditore për personat me aftësi të kufizuara me punë individuale, qendër ditore për persona të moshuar, qendër ditore për persona të moshuar me pleqërim aktiv)

DOKUMENTAT E NEVOJSHME PËR APLIKIM (të cilat mund t'i gjeni në faqen e internetit ssip.com.mk)

1. Formular për aplikim ([link për formularin](#))
2. Listë për kontrollimin e dokumenteve për aplikim – ([link për kontrollim](#))
3. Vendim për themelimin e Këshillit Komunal për Mbrojtje Sociale (kopje) ose Deklaratë se do të krijohet deri në ditën e fillimit të shërbimit (forma e deklaratës nuk është përcaktuar).
4. Plani social i komunës (kopje) ose deklaratë se do të sigurohet deri në datën e fillimit të ofrimit të shërbimit.
5. Skringing lista për mjedis jetësor dhe aspektet sociale ([link për SMJAS](#))
6. Buxheti në fomat Excel ([link për shabllonin](#))
7. Marrëveshje për lëshim falas të hapësirës komunale te ofruesi i shërbimit brenda 5 viteve (në rastin kur bëhet fjalë për hapësirë komune).
8. Fletë pronësie dhe marrëveshje qiraje për hapësirën ku do të ofrohet shërbimi (kopje).
9. Marrëveshja e bashkëpunimit (partneritetit) që rregullon detyrimet ndërmjet komunës dhe ofruesit të shërbimit për zhvillimin e shërbimit social përkatës (nuk është krijuar model marrëveshjeje)

SHUMA E MJETEVE TË ALOKUARA

Lartësia e mjeteve dhe shuma e tyre përcaktohet si shuma maksimale, e llogaritur si shuma e:

- Shpenzimet për krijimin e shërbimit social –
- Shpenzimet për ofrimin e shërbimit social – për një periudhë 12 mujore.

Baza për llogaritjen e shpenzimeve:



PROJEKT PËR PËRMIRËSIMIN E SHËRBIMEVE SOACIALE

Shpenzimet llogariten në bazë të dokumenteve dhe rregulloreve të mëposhtme:

- **Rregulloret pozitive që rregullojnë normat dhe standardet për ofrimin e shërbimit të duhur social.**

Shërbimet në shtëpi: Rregullore për mënyrën dhe vëllimin e shërbimeve sociale, normat dhe standardet për ofrimin e shërbimeve sociale, asistencës dhe kujdesit në shtëpi.

[link për Rregulloren për ndihmën dhe kujdesin në shtëpi](#)

[link për ndryshimet në rregulloren e 2021](#)

[link për ndryshimet në rregulloren e 2023](#)

Shërbimet në Komunitet: Rregullore për mënyrën, fushëveprimin, normat dhe standardet e ofrimit të shërbimeve sociale për kujdesin ditor, rehabilitimin dhe riintegrimin dhe risocializimin dhe për hapësirën, mjetet, stafin dhe dokumentacionin e nevojshëm për qendrën ditore, qendrën e rehabilitimit dhe qendrën e risocializimit.

[link për Rregulloren e Shërbimeve Ditore](#)

[link për ndryshimet në rregulloren \(2021\)](#)

[link për ndryshimet në rregulloren \(2023\)](#)

- **Elemente për formimin e çmimeve për krijimin e shërbimeve, në përputhje me standardet dhe normat për shërbimet sociale (të disponueshme në [Metodologjia/elementet për formimin e çmimeve për krijimin e shërbimeve në varësi të standardeve dhe normave për shërbimet sociale](#));**
- **Fleta e shpenzimeve për krijimin e shërbimeve sociale ([link për fletën e shpenzimeve](#))**
- **Vendimi i fundit për përcaktimin e çmimeve të shërbimeve sociale për ofrimin e shërbimeve me numër 02-8155/2 datë 18.12.2024 ([link për Vendimin](#))**
- **Projekt propozim i dorëzuar nga aplikuesi, me shpenzime të planifikuara për krijimin dhe ofrimin e shërbimit social.**



PROJEKT PËR PËRMIRËSIMIN E SHËRBIMEVE SOACIALE

Shpenzimet e llogaritura në përputhje me dokumentet e mësipërme dhe Manualin Operativ për Administrimin e Granteve për Zhvillimin e Shërbimeve Sociale, Versioni nr. 3 dhe të miratuara nga Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë (MPSDR) konsiderohen si shpenzime të mbështetura.

Shpenzime të cilat nuk mund të financohen me mjete nga granti:

- Blerja e tokës.
- Shtetëzimi i detyruar i tokës.
- Blerja e pajisjeve dhe mobiljeve të përdorura.
- Shpenzime që nuk parashikohen në marrëveshjen e grantit.

Shpenzimet që nuk janë realizuar në përputhje me procedurat e prokurimit të përcaktuara në Manualin Operativ për Administrimin e Granteve për Zhvillimin e Shërbimeve Sociale dhe që nuk janë miratuar nga EUP

PËRSHTATSHMËRI PËR APLIKIM PËR MARRJEN E GRANTIT

Përshtatshmëria për aplikim dhe marrjen e granteve për zhvillimin e shërbimeve sociale në nivel lokal vlen për komunat dhe ofruesit e shërbimeve që janë partnerë në aplikim.

Komuna nuk është e përshtatshme për aplikim nëse:

- nuk ka dorëzuar dëshmi për formimin e Këshillit Komunal për Mbrojtjen Sociale dhe kopje të Planit Social për zonën e komunës ose deklaratë se do t'i sigurojë ato deri në datën e fillimit të ofrimit të shërbimit nëse zgjidhet;
- Komuna(t) janë mbështetur financiarisht nga MPSDR/PPSHS për zhvillimin e shërbimit përkatës në thirrjet e mëparshme për dhënie grantesh (shembull: nëse një komunë e caktuar ka aplikuar dhe ka marrë një grant për zhvillimin e shërbimit të kujdesit dhe ndihmës në shtëpi, e njëjta komunë nuk ka të drejtë të marrë sërish një grant brenda PPSHS-së për shërbimin e kujdesit dhe ndihmës në shtëpi);
- aktualisht financohet nga një institucion/organizatë tjetër për krijimin dhe/ose ofrimin e të njëjtit shërbim.
- Në komunën/at ekziston ofrues shërbimi që ka lidhur një marrëveshje menaxhuese me MPSDR për të njëjtin shërbim (për shembull: nëse ka një ofrues të shërbimeve të



PROJEKT PËR PËRMIRËSIMIN E SHËRBIMEVE SOACIALE

kujdesit dhe ndihmës në shtëpi që ka lidhur një marrëveshje menaxhimi me MPSDR, ajo komunë nuk ka të drejtë të aplikojë për të njëjtin shërbim).

Ofruesi i shërbimit nuk është i përshtatshëm të aplikojë nëse:

- posedon licencë për të kryer veprimtari në fushën e mbrojtjes sociale për një shërbim të caktuar, pavarësisht nëse shërbimi ofrohet komercialisht apo mbështetet nga MPSDR/PPSHS për territorin e komunës për të cilën aplikon (shembull: një ofrues shërbimi që ka licencë për të kryer veprimtari/është i licencuar për të zhvilluar shërbimin e ndihmës dhe kujdesit në shtëpi në territorin e komunës së përcaktuar, nuk mund të aplikojë për të zhvilluar të njetin shërbim në të njëjtën komunë);
- aktualisht financohet nga një institucion/organizatë tjetër për krijimin dhe/ose ofrimin e të njëjtit shërbim.

Kufizimet gjatë aplikimit:

- Çdo komunë mund të dorëzojë vetëm një aplikacion në kuadër të kësaj thirrjeje publike.

KRITERET PËR VLERËSIM DHE PËRZGJEDHJE TË APLIKACIONEVE

Kriteret për përzgjedhjen e aplikacioneve që do të mbështeten janë përcaktuar në Manualin Operativ për Administrimin e Granteve për Zhvillimin e Shërbimeve Sociale Versioni 3 ([link për manualin](#)).

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve është 21.02.2025 deri në ora 16:00.

Mënyra e dorëzimit:

Aplikacionet duhet të dorëzohen në mënyrë elektronike në e-mail:
info.ssip@mtsp.gov.mk



PROJEKT PËR PËRMIRËSIMIN E SHËRBIMEVE SOACIALE

Dhe me postë në adresën e mëposhtme:

Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë
Projekt për përmirësimin e shërbimeve sociale
Rr. Dame Gruev nr. 14, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

Me shënimin "Thirrje publike drejtuar komunave dhe komunave në qytetin e Shkupit dhe ofruesve të mundshëm të shërbimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut për të aplikuar për grant për zhvillimin e shërbimeve sociale".